

MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIN E ZGJEDHJEVE Maqedonia e Veriut, Zgjedhjet presidenciale, 21 prill 2019

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Në raundin e parë të zgjedhjeve për president të shtetit, votuesit ishin në gjendje të bëjnë një zgjedhje të informuar në mes vizioneve politike në garrë, liritë fundamentale të asamblesë dhe shprehjen e respektuar në kampanjë. Përveç disa sfidave në aspektin teknik, zgjedhjet ishin në përgjithësi mirë të administruara. Zbrazëtitat ligjore ishin pjesërisht të trajtuara përmes marrëveshjeve ndërpartiake, por mbetet nevoja për finalizim të reformave të inicuar paraprakisht lidhur me legjislacionin zgjedhor. Dita e zgjedhjeve ishte e rregullt dhe transparente, dhe e vlerësuar në përgjithësi pozitivisht nga vëzhguesit e MNVZ-së.

Korniza ligjore në përgjithësi është e përshtatshme për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, disa dispozita të Kodit Zgjedhor nuk pasqyrojnë kërkesat specifike për garë presidenciale. Zbrazëtitat ligjore zvogëluar sigurinë ligjore dhe krijuan konfuzion në mes palëve të interesuara. Në mungesë të rregullave të qarta lidhur me kampanjën për kandidatët presidencial, elemente të fushatës u mbajtën në baza të marrëveshjeve ndërpartiake të cilat nuk ofruan mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët. Shumë rekomandime paraprake të ODIHR dhe të Këshillit të Europës lidhur me kornizën ligjore mbetën të patrajtuara, duke përfshirë këtu edhe ato që kanë të bëjnë me finansimin e kampanjës si dhe të kundërshtimeve dhe ankesave zgjedhore.

Administrata e zgjedhjeve përmbushi funksionet kyçe, veprimi kolegjisht dhe gëzoi besim nga ana e shumicës së palëve të interesuara. KSHZ-ja, megjithatë, u vonua me disa përgatitje, siç janë dhënja e udhëzimeve, shtypja e materialeve të trajnimeve, si dhe formimi i komisioneve të shkallëve më të ulëta. Transparenca dhe efikasiteti i KSHZ-së ishte, nganjëherë, i penguar nga funksionimi jo i mirë i sistemeve të informacionit dhe komunikimit, që gjithashtu ngriti çështjet lidhur me sigurinë e sistemit të sigurimit të TIK. KSHZ-ja zbatoi edukimin e votuesve në mediat e transmetimit dhe ato sociale në shumë gjuhë dhe ndonjëherë edhe me interpretim në gjuhën e shenjave, por dukshmëria e kësaj kampanje ishte e kufizuar.

Regjistrimi i votuesve bëhet nga ana e KSHZ-së dhe përfshin qytetarë të cilët janë banorë të regjistruar dhe posedojnë dokumente valide të identifikimit. Megjithatë, përjashtimi automatik i votuesve në bazë të vlefshmërisë së dokumenteve të tyre paraqiti pengesë për ushtrimin e të drejtës së votes, e cila ndikoi rreth 11.000 votues. Derisa palët e interesuara vunë në dukje përmirësime në saktësinë e regjistrimit të votuesve, mospërputhjet në bazat e të dhënave të ndryshme shtetërore dhe formave të ndryshme të të dhënave vazhdojnë të paraqesin një sfidë, që kërkon vëmendje shtesë.

U regjistruan tre kandidatë të cilët do të garojnë në këto zgjedhje, një grua dhe dy burra, dhe një nga ato është shqiptar etnik. Të tre kandidatët u regjistruan nga ana e KSHZ-së në një proces gjithëpërfshirës. Edhe pse u regjistruan si kandidatë jo-partiakë, secili nga tre kandidatët u mbështet nga parti politike para regjistrimit, dhe përdorën simbole partiake për identifikim në fletëvotim.

Fushata u zhvillua në ambient të qetë dhe paqësor. Liritë themelore për tubim dhe shprehje u respektuan, dhe pjesëmarrësit në zgjedhje ishin në gjendje të zhvillojnë fushatë lirshëm dhe pa pengesa. Udhëheqësit e partive kishin paraqitje dominante në fushatë pavarësisht se kandidatët nuk ishin formalisht të lidhur me partitë politike. Në përgjithësi, zyrtarët shtetëror dukej se ishin të

kujdesshëm në mbajtjen e dallimit në mes aktiviteteve të tyre zyrtare dhe partiake dhe në shmangjen e përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë. Sidomos në këto zgjedhje, partia në pushtet si dhe disa parti etnike shqiptare përkrahën bashkërisht një kandidat presidencial. Dy kandidatë shpesh ngritën çështjen lidhur me pjesëmarrjen e grave dhe barazisë gjinore.

Fushatat u finansuan nga donacione të individëve dhe të personave juridik dhe disa nga kandidatët pranuan përkrahje financiare nga partitë politike. Reklamata politike në mediat transmetuese do të kompenzohen nga fondet shtetërore. Enti Shtetëror i Revizionit është organi kryesor mbikqyrës, por mbikqyrja e tij është e kufizuar në auditim të informacionit të parashtruar nga ana e garuesve zgjedhor dhe nuk ka kapacitet për të hetuar nëse ai informacion është i saktë dhe i tërësishëm. Nuk kishte raportim të unifikuar të harxhimeve të kandidatëve, pa rregullativë të qartë lidhur me zhvillimin e fushatës nga palët e treta dhe nuk ka kërkesa për llogaridhënie për shpenzimet e bëra nga partitë politike që i mbështesin kandidatët. E tërë kjo zvogëloi transparencën e finansimit të kampanjës dhe efikasitetin e mbikqyrjes.

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it konstatoi se transmetuesi publik ofroi mbulim të paanshëm dhe në përgjithësi media prezantoi informata të ndryshme për kandidatët dhe të partive politike të cilat i përkrahin, përmes programeve të ndryshme dhe debateve televizive me të gjithë kandidatët. Kjo ju mundësoi votuesve një mundësi për të bërë një vendim të informuar. Rregullatori mediatik përbushoi detyrimet ligjore dhe kreu monitorim të mbulimit mediatik të fushatës.

Korniza ligjore nuk siguron plotësisht korigjim ligjor efektiv që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës. E drejta e kufizuar për parashtrimin e kundërshtimeve dhe ankesave në procesin zgjedhor le parregullsitë e mundshme pa mjet efektiv ligjor. Vendimet e KSHZ-së lidhur me kundërshtimet e parashtruara në procesin parazgjedhor uvshqyrtaun brenda afatit ligjor, por vendimet nuk kishin arsytim adekuat. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) pranoi 13 kundërshtime me pretendim të keqpërdorimit të burimeve shtetërore gjatë fushatës, shumica e të cilave u gjetën si të pabaza.

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe e rregullt. Procesi i votimit ishte i qetë dhe procedurat në përgjithësi u ndoqën. Numërimi dhe nxjerja e rezultateve në përgjithësi u vlerësuan si pozitive. KSHZ-ja filloi me publikimin e rezultateve paraprake në ueb-faqen e sajë një orë pas mbylljes së vendvotimeve, të ndara sipas komunave dhe sipas vendvotimeve, gjë që mundësoi transparencë. Një numër relativisht i lartë i fletëvotimeve jovalide theksoi nevojën për instruksione dhe trajnime më të qarta.

GJETJET PARAPRAKE

Sfondi

Më 8 shkurt të vitit 2019, kryetari i Kuvendit i shpalli zgjedhjet presidenciale për më 21 prill. Kryetari aktual i vendit, Gjorge Ivanov, për herë të parë u zgjodh në vitin 2009, i mbështetur nga partia e atëhershme në pushtet, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), ndërsa u rizgjodh për mandatin e dytë dhe të fundit në prill të vitit 2014. Kriza e zgjatur politike në vitet në vijim çoi në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016, të cilat në fund rezultuan me qeveri të re të udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) në koalicion me partinë, kryesisht me shqiptarë etnikë, Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI), e cila më parë ka qenë në koalicion me VMRO-DPMNE-në.¹

¹ Në koalicionin në pushtet, blloku i udhëhequr nga LSDM-ja ka 49 deputetë, BDI-ja - 10, AlternativA - 3, Partia Demokratike Shqiptare - 2 dhe Rilindja Demokratike Kombëtare -1. Blloku opozitar i udhëhequr nga VMRO-

Partitë tradicionalisht kanë garuar për vota kryesisht brenda bashkësive të tyre etnike, ndërsa koalicionet në pushtet janë formuar përtej ndarjes etnike, duke i përfshirë partitë etnike shqiptare. Megjithatë, në zgjedhjet lokale të vitit 2017, LSDM-ja dhe BDI-ja i mbështetën kandidatët e njëri-tjetrit në disa gara, ndërsa LSDM-ja u përpoq t'i tërheqë votuesit etnikë shqiptarë. Në këto zgjedhje, dy kandidatë, Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska Davkova, u mbështetën nga blloqet politike të udhëhequra nga LSDM-ja, gjegjësisht VMRO-DPMNE-ja.² Kandidati i tretë, Blerim Reka, është mbështetur nga dy parti etnike shqiptare në opozitë, Aleanca për Shqiptarët (ASH) dhe BESA.³

Zgjedhjet mbahen në kontekst të zhvillimeve të rëndësishme për ambiciet e vendit për t'u anëtarësuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe Bashkimin Evropian (BE). Pas marrëveshjes dypalëshe me Greqinë ("Marrëveshja e Prespës") në qershor të vitit 2018 dhe të një referendumi kombëtar konsultativ në shtator, Kuvendi i miratoi ndryshimet kushtetuese më 11 janar për ta ndryshuar emrin kushtetues të vendit në përputhje me marrëveshjen. Më 6 shkurt, vendet anëtare të NATO-s nënshkruan një protokoll për pranimin e Maqedonisë së Veriut. Në periudhën parazgjedhore, kryeministri publikisht e potencoi rëndësinë e mbajtjes së zgjedhjeve për avancimin e përparimit të vendit drejt hyrjes në BE dhe anëtarësimit në NATO.

Sistemi zgjedhor dhe korniza ligjore

Kryetari i vendit zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme të drejtpërdrejta sipas sistemit të shumicës me mandat prej pesë vjetësh, më së shumti për dy mandate. Për t'u zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet ta fitojë shumicën e votave të votuesve të regjistruar. Përndryshe, mbahet rrethi i dytë brenda dy javëve ndërmjet kandidatëve që kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rrethin e dytë zgjidhet kandidati që ka fituar më shumë vota, me kusht që të ketë pjesëmarrje të votuesve prej së paku 40 për qind të votuesve të regjistruar. Përndryshe, i gjithë procesi zgjedhor përsëritet.⁴ Kushti i pjesëmarrjes në rrethin e dytë mund të çojë në cikle të zgjedhjeve të dështuara dhe është kritikuar më parë nga ODIHR-i dhe Komisioni i Këshillit të Evropës për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut).⁵

Zgjedhjet presidenciale kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutën e vitit 1991 dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2006.⁶ Me ndryshimet e paradokshme të Kodit Zgjedhor në vitin 2018 dhe 2019 u ndryshua përbërja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u zgjeruan kompetencat e tij, dhe u parapara kompensim për reklamimin e paguar politik nga buxheti shtetëror. Shumica e rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës mbeten të patrajuara në kornizën ligjore, duke i përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me financimin e fushatës, abuzimi i burimeve shtetërore dhe kundërshtimet dhe ankesat zgjedhore.⁷ Shumica e bashkëbiseduesve të MNVZ-së, duke e përfshirë edhe KSHZ-në, e nënvizuan nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të legjislacionit zgjedhor.⁸

DPMNE-ja ka 43 deputetë, Aleanca për Shqiptarët - 2, dhe BESA - 2. Edhe 8 deputetë të tjerë u dëbuan nga blloku i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja pas votimit të parë parlamentar për ndryshimet kushtetuese në vitin 2018. Dyzet e pesë deputetë janë gra, ndërsa 23 identifikohen si shqiptarë etnikë.

² Z. Pendarovski më parë kandidoi për kryetar të vendit në vitin 2014, po ashtu i mbështetur nga LSDM-ja.

³ BESA do të thotë "besë" në shqip.

⁴ Ligji nuk përcakton se kur duhet të mbahen zgjedhjet e përsëritura.

⁵ Shih Mendimet e përbashkëta të ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut për Kodin Zgjedhor të [2011](#) dhe [2013](#).

⁶ Korniza ligjore po ashtu e përfshin Ligjin për Partitë Politike të vitit 2004, Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004, Kodin Penal të vitit 1996, Ligjin për Media të vitit 2013 dhe Ligjin për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike të vitit 2013, si dhe udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

⁷ Ndryshimet ligjore u miratuan nga Kuvendi përmes një procedure të përshpejtuar, edhe atë, sipas bashkëbiseduesve të MNVZ-së, pa konsultim domethënës me palët e interesuara. Paragrafi 5.8 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) i obligon vendet pjesëmarrëse t'i miratojnë ligjet "në fund të një procedure publike".

⁸ Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut, qeveria, në konsultim me shoqërinë qytetare dhe partitë politike, ka ndërmarrë hapa për ta reformuar legjislacionin zgjedhor, mirëpo këto reforma akoma nuk janë realizuar dhe kërkojnë konsultime publike shtesë.

Në përgjithësi, korniza ligjore paraqet një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, megjithatë, disa dispozita të Kodit Zgjedhor nuk sigurojnë në mënyrë adekuate terren të barabartë për garat presidenciale. Për shembull, rregullat për mënyrën e ndarjes së kohës për reklamim në media dhe hapësirës reklamuese në bilborde u referohen vetëm partive politike parlamentare të aleancave në pushtet ose opozitare dhe nuk i përmendin kandidatët presidencialë. Këto zbrazëtira në rregullativë e dëmtojnë qartësinë ligjore dhe shkaktuan konfuzion te palët e interesuara.⁹ Në mungesë të rregullave eksplicite, çështjet e tilla u zgjodhën me marrëveshje politike ndërpartiake, sipas të cilave rregullat e Kodit Zgjedhor që vlejné për partitë politike do të vlejné edhe për kandidatët presidencialë por nuk ofruan mundësi të barabarta për të gjithë garuesit.¹⁰ Kandidatët nuk i kundërshtuan marrëveshjet e tilla.

Administrimi i zgjedhjeve

Zgjedhjet u administruan nga administrata në tre nivele, që përbëhet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK), dhe 3.396 Këshilla Zgjedhorë (KZ). Votimi jashtë vendit u zhvillua në 32 zyra diplomatike dhe konsullore në 24 vende.¹¹ Votimi i hershëm u administrua për disa kategori të votuesve më 20 prill.¹² Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në profesionalizmin dhe paanshmërinë e përgjithshme të administratës zgjedhore.

KSHZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë (duke i përfshirë tre gra) të emëruar nga partitë politike parlamentare.¹³ Gjatë periudhës parazgjedhore, komisioni mbajti mbledhje të rregullta publike, mirëpo këto mbledhje nuk i lajmëroi rregullisht paraprakisht.¹⁴ Propozim-vendimet u diskutuan nga KSHZ-ja në mbledhje paraprake të mbyllura, duke i kufizuar mbledhjet publike vetëm në votim formal, gjë që e zvogëloi transparencën. Besimi i disa palëve të interesuara ndaj KSHZ-së u zvogëlua nga mosveprimi i perceptuar i saj në lidhje me shkeljet e pretenduara në referendumin konsultativ të vitit 2018.

Në përgjithësi, KSHZ-ja funksionoi kolegjisht dhe e respektoi shumicën e afateve kohore ligjore. Megjithatë, disa përgatitje ishin të vonuara, si për shembull shtypja e doracakëve për trajnim për komisionet e nivelit më të ulët dhe tenderët për përgatitjen dhe shtypjen e fletëvotimeve dhe të listave të votuesve. Që nga 22 marsi, sistemi kyç informatik dhe i komunikimit i Komisionit nuk ka funksionuar si duhet, gjë që ka ndikuar në qasjen në kohë në informata, publikimin e procesverbaleve, udhëzimeve dhe vendimeve, kontrollimin onlajn të të dhënave të votuesve në regjistrin e votuesve, dhe regjistrimin onlajn të kundërshtimeve. Kjo ngriti çështjet lidhur me sigurinë TIK të KSHZ-së¹⁵. Në

⁹ Si përpjekje për t'i trajtuar disa nga këto zbrazëtira në ligj, më 27 mars u miratuan disa ndryshime të imta në Kodin Zgjedhor në momentin e fundit, megjithatë, ato nuk hynë në fuqi për këto zgjedhje.

¹⁰ Për shembull, kandidatit të mbështetur nga partitë në pushtet iu nda 40 për qind e hapësirës së përgjithshme komerciale në bilborde, ndërsa 40 për qind të tjera u ndanë ndërmjet dy kandidatëve të mbështetur nga partitë opozitare dhe 20 për qind të mbetura u ndanë ndërmjet tre kandidatëve sipas marrëveshjes së tyre të ndërsjellë.

¹¹ Për votimin jashtë vendit, KSHZ-ja regjistroi 1.781 votues nga gjithsej 1.826 kërkesa të pranuar.

¹² Votuesit në shtëpi, personat e zhvendosur në brendi të vendit, votuesit në institucionet ndëshkuese, si dhe në një shtëpi pleqsh dhe në një spital special në Shkup. Votimi i hershëm u mundësua edhe më 18 prill në KSHZ për anëtarët e KZ-ve që e administruan votimin jashtë vendit.

¹³ Katër anëtarë u emëruan nga partitë në pushtet, duke e përfshirë edhe nënkryetarin, ndërsa tre nga partitë opozitare, duke e përfshirë edhe kryetarin e KSHZ-së. Mandati i KSHZ-së aktuale, i cili fillimisht ishte caktuar për gjashtë muaj për ta administruar referendumin e vitit 2018, në nëntor të vitit 2018 u zgjat më së shumti deri në dy vjet.

¹⁴ Mbledhjet u mbajtën në gjuhën maqedonase, edhe pse në raste të jashtëzakonshme vendimet kryesore u publikuan edhe në gjuhën shqipe. Në disa mbledhje u ofrua edhe interpretim në gjuhën e shenjave.

¹⁵ Sipas KSHZ-së, sistemet e afektuar nga softueri ransomware GEFEST 3.0 përfshinë serverë të fajleve dhe të e-mailave, që gjithashtu ndikoi në qasjen e regjistrin të votuesve dhe në bazën e të dhënave të punonjësve publik që përdoret për caktim të KZ-ve. Veçmas, ueb-faqja e KSHZ-së nuk ishte e qasshme ndërmjet 9 dhe 11 prillit.

përputhje me mandatin e saj për të siguruar zbatim të njëjtë të ligjit, KSHZ-ja publikoi rregulla, edhe pse ndonjëherë relativisht vonë në procesin zgjedhor.¹⁶

KZK-të, të cilat janë emëruar në vitin 2016, përbëhen nga pesë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KSHZ-ja nga radhët e punonjësve të administratës shtetërore dhe komunale me mandat prej pesë vjetësh. MVZ-ja e ODIHR-it i vizitoi të gjitha 80 KZK-të përpara ditës së zgjedhjeve. Në përgjithësi, KZK-të filluan me punën e tyre sipas planit të paraparë, me pajisje dhe burime operative adekuate.¹⁷

KZ-të përbëhen nga tre anëtarë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve shtetërorë me mandat katërvjeçar, si dhe nga dy anëtarë të përkohshëm të emëruar nga partitë parlamentare për çdo zgjedhje. Anëtarët e tanishëm jo-partiakë të KZ-ve u emëruan në vitin 2017. Shumica e KZK-ve e përfunduan formimin e KZ-ve në kohë, edhe pse mungesa e qasjes në bazën e të dhënave të KSHZ-së për anëtarët potencialë të KZ-ve e vonoi procesin e formimit të KZ-ve në disa raste.¹⁸

Kërkesat ligjore për përfaqësim gjinor dhe etnik në administratën zgjedhore u respektuan në masë të madhe.¹⁹ Në rastet kur në radhët e administratës publike kishte mungesë të punonjësve të përshtatshëm për t'u emëruar si anëtarë, veçanërisht në mesin e grave nga bashkësitë pakicë, KSHZ-ja dhe KZK-ja duhej të zgjedhin anëtarë nga komunat e tjera.²⁰ Përfaqësuesit e bashkësive më të vogla etnike në vend, duke i përfshirë romët, ia shprehën mendimet e tyre MVZ-së së ODIHR-it se nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në organet zgjedhore, sikurse edhe në organet e tjera shtetërore. Edhe pse gratë ishin të përfaqësuar mirë në administratën zgjedhore, ato ishin më pak të përfaqësuar në pozitat udhëheqëse: vetëm 27 nga 80 kryetarë të KZK-ve janë gra, dhe vetëm X nga X kryetarë të KZ-ve.

KZK-të mbajtën trajnime për të gjithë anëtarët e KZ-ve, ndërsa kryetarët e KZ-ve dhe zëvendësit e tyre kanë ndjekur trajnime shtesë nga trajnerë të certifikuar nga KSHZ-ja. Edhe pse këto seanca trajnuese ishin interaktive dhe kryesisht të organizuara mirë, trajnimet e ofruara nga KZK-të kryesisht ishin mbështetur në prezantim me video të procedurave të ditës së zgjedhjeve. KSHZ-ja i përgatiti materialet për trajnim në pesë gjuhë dhe në mesin e trajnuesve kishte trajnues që flisnin në gjuhët e pakicave, megjithatë, doracakët e trajnimeve nuk ishin në dispozicion në formë të shtypur për anëtarët e KZ-ve deri një ditë më parë të ditës së zgjedhjeve. MVZ-ja e ODIHR-it vërejti se gjuhët e pakicave nuk përdoreshin vazhdimisht në grupet e përziera gjuhësore.

Pozitivisht, KSHZ-ja i vendosi videot për edukimin e votuesve në platformat e saj në mediat sociale në gjuhën maqedonase dhe shqipe, të mbështetura me interpretim në gjuhën e shenjave dhe ndonjëherë me titra në gjuhën rome, sërbe, turke dhe vllahe. Edukimi i votuesve u bë edhe në mediat transmetuese dhe

¹⁶ Në udhëzimet e tilla bënin pjesë ato që kishin të bëjnë me plotësimin e protokolleve të rezultateve dhe nxjerrjen e rezultateve dhe për përmbljedhjen e rezultateve paraprake duke e përdorur aplikacionin *Viber*.

¹⁷ Megjithatë, 13 KZK e informuan MVZ-në e ODIHR-it se nuk kishin mjete të mjaftueshme financiare, hapësira adekuate ose pajisje të TIK-ut.

¹⁸ Rreth dy javë para ditës së zgjedhjeve, 90 KZ që u takojnë 8 KZK-ve nuk ishin kompletuar. Afati i fundit për formimin e KZ-ve ishte 1 marsi, ndërsa për KZK-të ishte 21 shkurti.

¹⁹ Sipas Kodit Zgjedhor, çdo gjini duhet të përfaqësohet nga të paktën 30 për qind e anëtarëve, e po ashtu duhet të përfaqësohen edhe të gjitha bashkësitë etnike që përbëjnë të paktën 20 për qind të popullsisë në komunën përkatëse në mënyrë adekuate dhe të drejtë. Nga 80 KZK, pesë nuk e kanë respektuar kërkesën për përfaqësim gjinor, ndërsa njëra për balancën etnike.

²⁰ Për shembull, KZK-ja në Studeniçan njoftoi se anëtarët e saj duhej të rekrutohen nga komuna fqinje për shkak të numrit të kufizuar të maqedonasve etnikë në administratën publike.

përfshinte informata mbi të drejtat e votuesve, procedurat e votimit dhe shkeljet zgjedhore.²¹ Përkundër këtyre përpjekjeve, dukshmëria e edukimit të votuesve ishte e limituar.²²

Më 8 prill, KSHZ-ja vendosi t'i zhvendosë 82 vendvotime me më pak se 10 votues të regjistruar në vendvotimet e afërta, por me kuti të posaçme votimi.²³ Numri i vogël i prituri i votave në këto kuti votimi shkaktoi shqetësime se nuk do të ruhej fshehtësia e votës.²⁴

Regjistrimi i votuesve

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, personat me aftësi të kufizuara mendore të cilëve u është marrë e drejta e votimit me vendim gjyqësor, janë të privuar nga votimi.²⁵

Banorët e regjistruar në vend janë të përfshirë në regjistrin e votuesve nëse posedojnë letërnjoftim të vlefshëm ose pasaportë. Votuesit, të cilëve u kishte skaduar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim para ditës së zgjedhjeve, u përjashtuan automatikisht nga listat e votuesve, përveç nëse e kishin rinovuar dokumentin e tyre dhe e kishin njoftuar zyrën rajonale të KSHZ-së për këtë ndryshim para 14 marsit. Që nga 1 marsi, votuesit kishin mundësi t'i rinovojnë ose t'i zëvendësojnë letërnjoftimet e tyre me procedurë të përsheptuar. Megjithatë, përjashtimi automatik i votuesve në bazë të vlefshmërisë së dokumenteve të tyre paraqiti pengesë për ushtrimin e së drejtës së votës, gjë që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.²⁶ Sipas KSHZ-së, nga kjo dispozitë janë ndikuar rreth 11.000 votues.

Sistemi i regjistrimit për votimin në vend është pasiv dhe i vazhdueshëm, dhe bazohet në informatat e nxjerra nga regjistrat civilë dhe regjistrat e tjerë kombëtarë.²⁷ Edhe pse KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të votuesve, ajo nuk ka kapacitet që ta administrojë përpunimin organizativ, teknik dhe metodologjik të të dhënave, të cilën e bën Enti Shtetëror Statistikor. Mospërputhjet ndërmjet bazave të të dhënave të ndryshme shtetërore dhe formateve të ndryshme të të dhënave e vështirësojnë mirëmbajtjen e regjistrit të votuesve, ndërsa mangësitë strukturore të identifikuar në raportet e mëparshme të ODIHR-it mbeten të patrajtuara.²⁸ Shumë bashkëbisedues të

²¹ Fushata mediatike u plotësua me turne të një minibusi informativ anembanë vendit. KSHZ-ja po ashtu hapi linjë telefonike falas për pyetjet e votuesve.

²² Video me titra në gjuhën e pakicave u botuan vonë në kampanjë, ndërsa ato në mediat sociale patën shikueshmëri të ulët. KSHZ-ja informoi MNVZ-në se fushëveprimi i edukimit të votuesve ishte limituar nga kufizimet në buxhet.

²³ Sipas ligjit, nuk mund të krijohet vendvotim atje ku ka më pak se 10 votues të regjistruar.

²⁴ Shih paragrafi 7.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990. Shih po ashtu nenin 25 të KNDCP.

²⁵ Shih nenet 12 dhe 29 të [Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006](#). Shih gjithashtu paragrafin 9.4 të [Komunikatës Nr. 4/2011 të Komisionit të KDPK-së të vitit 2013](#), ku thuhet se "Neni 29 nuk parasheh asnjë kufizim të arsyeshëm, e as që lejon ndonjë përjashtim për cilin do grup personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, përjashtimi i të drejtës për të votuar në bazë të paaftësisë së perceptuar ose aktuale psikosociale ose intelektuale, duke përfshirë kufizimin në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, në kuptim të nenit 2 të Konventës".

²⁶ Kushtetuta (neni 22) thotë se "çdo qytetar që ka mbushur 18 vjet e fiton të drejtën e votës". Shih po ashtu paragrafin 11 të [Kommentit të përgjithshëm nr. 25 të Komisionit për të drejtat e njeriut të KB-ve](#): "Vendet patjetër duhet të marrin masa efektive për të siguruar se të gjithë personat që kanë të drejtë vote kanë mundësi ta ushtrojnë këtë të drejtë. Në rastet kur kërkohet regjistrimi i votuesve, kjo duhet të lehtësohet dhe nuk duhet të vendosen pengesa për regjistrimin e tillë."

²⁷ Ministria e Punëve të Brendshme i ofron KSHZ-së informata për qytetarët që e kanë arritur moshën e pjekurisë dhe për lëshimin e letërnjoftimeve dhe pasaportave në bazë të të regjistruarve të shtetësisë dhe të vendbanimit. Gjykatat themelore informojnë KSHZ-në për qytetarët e privuar nga e drejta ligjore për të votuar dhe ata që gjenden në paraburgim. Ministria e Drejtësisë ofron informata për personat e vdekur.

²⁸ Dispozitat ligjore që e rregullojnë regjistrin e adresave, duke përfshirë azhurnimin e shënimeve, fshirjen e adresave të skaduar dhe parandalimin e regjistrimit në adresa me prova të pamjaftueshme, nuk janë konsekuente, siç janë

MVZ-së së ODIHR-it i potencuan përmirësimet në saktësinë e regjistrimit të votuesve, por vazhduan të shprehin shqetësime rreth përfshirjes së votuesve të vdekur dhe mospërputhjeve në të dhënat e adresës. Ndërkohë që regjistrimi i popullsisë nuk është i lidhur me regjistrimin e votuesve, mungesa e një regjistrimi të fundit të popullatës kontribuoi në spekulimet e palëve të interesuara lidhur me saktësinë e regjistrimit të votuesve. Po ashtu u vu në dukje se numri i konsiderueshëm i qytetarëve që banojnë jashtë vendit, por që mbeten banorë të regjistruar në vend dhe vendosën të mos marrin pjesë në zgjedhje, mund të ndikojë në kufirin e pjesëmarrjes.

Ndërmjet 23 shkurtit dhe 14 marsit, listat e votuesve u nxorën për këqyrje publike në zyrat rajonale të KSHZ-së.²⁹ Sipas KSHZ-së, 53.972 votues i kontrolluan të dhënat e tyre në zyrat rajonale, duke i përfshirë edhe votuesit që erdhën për t'u nënshkruar në listat për emërimin e kandidatëve.³⁰ KSHZ-ja siguroi kopje të regjistrimit të votuesve për pesë parti parlamentare pas përfundimit të këqyrjes publike, Regjistri përfundimtar përfshinte 1.808.131 votues.

Regjistrimi i kandidatëve

Sipas Kushtetutës, një shtetas që ka mbushur së paku 40 vjet, i cili ka banuar në vend së paku 10 vjet nga 15 vitet e fundit, ka të drejtë të kandidojë për postin e kryetarit të vendit. Kërkesa për banim në vend bie ndesh me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet ndërkombëtare.³¹

Kandidatët patjetër të emërohen prej së paku 10.000 votuesve ose 30 deputetëve. Siç kërkohet me ligj, nënshkrimet për mbështetje nga votuesit u mblodhën përpara personave zyrtarë në hapësirat e 34 zyrave rajonale të KSHZ-së, dhe 45 zyra të përkohshme ndërmjet 23 shkurtit dhe 9 marsit. Votuesit me nënshkrimin e tyre mund të mbështesin më shumë kandidatë. Nga nëntë kandidatët potencialë që e shpallën qëllimin e tyre për të mbledhur nënshkrime, tre arritën ta mbledhin numrin e nevojshëm të nënshkrimeve.³² Shumica e bashkëbiseduesve të MNVZ-së nuk ngritën shqetësime rreth procesit të mbledhjes së nënshkrimeve dhe regjistrimit të kandidatëve.

KSHZ-ja i pranoi dhe i shqyrtoi dokumentet për emërim brenda afatit ligjor, dhe kandidatët u regjistruan më 21 mars, duke përfshirë një grua dhe një shqiptar etnik. Edhe pse u regjistruan si kandidatë jo-partiakë, secili nga tre kandidatët u mbështet nga parti politike para mbledhjes së nënshkrimeve dhe regjistrimit, dhe përdorën simbole partiake për identifikim në fletëvotim.

Fushata

Fushata u zhvillua në ambient të qetë dhe paqësor. Liritë themelore për tubim dhe shprehje u respektuan, dhe pjesëmarrësit në zgjedhje ishin në gjendje ta zhvillojnë fushatën lirshëm dhe pa pengesa. Periudha zyrtare e fushatës filloi më 1 prill, 20 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundoi 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve. Dispozitat e Kodit Zgjedhor në lidhje me zhvillimin e hershëm të fushatës janë të paqarta. Edhe pse kandidatët e ndërprejnë fushatën pas regjistrimit të tyre formal deri në

edhe përkufizimet e vendbanimit të përkohshëm dhe të përhershëm të qytetarëve që jetojnë në vend dhe jashtë vendit. Përveç kësaj, rregulla që kërkon që personat ta deklarojnë ndryshimin e adresës nuk zbatohet gjithmonë.

²⁹ MVZ-ja e ODIHR-it u informua se lista e votuesve nuk u vendos publikisht në disa zyra, duke përfshirë Kumanovën, Gjevgjelinë, Prilepin, Strumicën dhe Shtipin.

³⁰ Si rezultat i këqyrjes publike, 517 votues u futën në listat e votuesve, 412 u përjashtuan, ndërsa të dhënat e 129 votuesve u korrigjuan.

³¹ Shih po ashtu paragrafin 15 të [Komentit të përgjithshëm nr. 25 të Komisionit për të drejtat e njeriut të KB-ve](#): "personat që përndryshe kanë të drejtë të kandidojnë për t'u zgjedhur nuk duhet të përjashtohen me anë të kërkesave të paarsyeshme ose diskriminuese siç janë arsimit, vendbanimi ose prejardhja, ose për shkak të përkatësisë politike". Shih gjithashtu Paragrafin 7.3 të [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) dhe seksionet I.I.1.c.iiiiv-v të [Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut](#) (Kodi i praktikës së mirë).

³² Sipas KSHZ-së, z. Reka u mbështet me 11.128 nënshkrime të votuesve, znj. Siljanovska-Davkova me 15.926, dhe z. Pendarovski me 31.729. Procesi përfundoi para fillimit me punë të MVZ-së së ODIHR-it.

fillimin e periudhës së fushatës, partitë politike vazhduan me aktivitetet e tyre, duke përfshirë edhe përkrahjen e kandidatëve presidencialë pas të cilëve qëndrojnë.³³

Kandidatët zhvilluan fushatë të gjerë në gjithë vendin duke përdorur mjete të llojllojshme tradicionale, si dhe duke i përdorur në mënyrë aktive platformat e mediave sociale. Secili kandidat zhvilloi ngjarje të vogla për t'u takuar me votuesit, si dhe tubime më të mëdha së bashku me udhëheqësit e partive, të cilët u paraqitën dukshëm në kampanjë. Edhe pse dispozitat e Kodit Zgjedhor në lidhje me ndarjen e bilbordeve komerciale ishin të paqarta (shih Korniza ligjore), në praktikë vendosja e materialeve të jashtme të fushatës nuk u tregua kontestuese. Aktivistët lokalë zhvilluan fushatë derë më derë dhe shpërndanë fletëpalosje. Edhe pse formalisht të pavarur, z. Pendarovski dhe znj. Siljanovska Davkova u varën shumë nga mbështetja organizative e partive. Marrëveshja e Prespës dhe hyrja në NATO dhe BE ishin çështje të rëndësishme në fushatë, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Edhe pse kandidatët në përgjithësi iu shmangën retorikës së ashpër, raste të retorikës nxitëse u përdorën në fjalimet e përafësuesve partiak në mediat tradicionale dhe sociale.³⁴ Në ditët e fundit të kampanjës, u shfaqën polemika publike lidhur me pretendimet e opozitës se një aplikacion në celular i SDSM-së për aktivistët e kampanjës bën keqpërdorimin e të dhënave personale, gjë që u mohua nga ana e SDSM-së.³⁵

Kodi Zgjedhor përmban dispozita që e mbështesin parimin e ndarjes së shtetit nga partia dhe e ndalojnë keqpërdorimin e burimeve shtetërore.³⁶ Siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, kandidatët e nënshkruan premtimin se nuk do të ushtrojnë presion mbi punonjësit e sektorit publik. Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë prezantoi një mjet onlajn nëpërmjet të cilit punonjësit publikë mund ta denonconin në mënyrë anonime çdo rast të presionit mbi ta.³⁷ Përderisa MVZ-ja e ODIHR-it pranoi disa pretendime se punonjësve të sektorit publik u ishin bërë presione për të marrë ose për të mos marrë pjesë në ngjarje të fushatës, nuk u konfirmua asnjë pretendim konkret. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, politizimi i emërimeve në sektorin publik krijon një perceptim të përhapur gjerësisht se punonjësit duhet t'i mbështesin partitë në pushtet, madje edhe në mungesë të udhëzimeve të qarta për këtë.

Në përgjithësi, funksionarët shtetërorë u dukën të kujdesshëm për të mbajtur vijë ndarëse të aktiviteteve të tyre zyrtare dhe të atyre partiake duke mos i përdorur burimet shtetërore apo duke mos u angazhuar në fushatë gjatë orëve të punës. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) ka mandat të reagojë ndaj keqpërdorimeve të mundshme të burimeve shtetërore. Megjithatë, KSHPK-ja nuk ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të funksionuar në mënyrë efektive dhe nuk ka zhvilluar një metodologji të qartë për t'i monitoruar zgjedhjet. KSHPK-ja publikoi një bazë të dhënash të automjeteve që u përkisnin institucioneve shtetërore dhe u mbështet në organizatat e shoqërisë civile për të denoncuar nëse këto automjete ishin përdorur për zhvillim të fushatës; u parashtrua vetëm një denoncim i tillë.

³³ Sanksione mund të ju shqiptohen personave juridik në qoftë se bëjnë aktivitete të fushatës jashtë periudhës së kampanjës. KSHZ-ja i hodhi poshtë tre kundërshtime në të cilat pretendohet se znj. Siljanovska Davkova dhe z. Pendarovski kanë zhvilluar fushatë para kohe.

³⁴ Duke përfshirë kundër z. Reka në ngjarje të fushatës kryesisht nga partitë etnike shqiptare në koalicionin qeveritar, si dhe kundër z. Pendarovski në përmbatjet tradicionale dhe onlajn.

³⁵ Nuk u paraqit asnjë provë bindëse deri te MNVZ se të dhënat personale janë komprometuar nga aplikacioni. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale informoi MNVZ-në se është duke hetuar pretendimet.

³⁶ Dispozitat përfshijnë moratorium për shpalljen e projekteve të reja të financuara me mjete publike dhe ndalesë për përdorimin e zyrave, pajisjeve apo punonjësve shtetërorë. Disa objekte nuk mund të përdoren për ngjarje të fushatës, duke përfshirë objektet fetare, spitalet, shkollat, shtëpitë e pleqve dhe institucionet e tjera publike, përveç nëse nuk ka ndonjë vend tjetër të përshtatshëm që është në dispozicion.

³⁷ Sipas Ministrisë, u raportuan katër raste të paraqitura lidhur me përdorimin e kësaj vegje, por që nuk kishin të bëjnë me zgjedhjet.

Popullsia përbëhet nga disa bashkësi etnike.³⁸ Një tipar i rëndësishëm i fushatës zgjedhore ishte kandidatura e z. Pendarovskit mori mbështetje jo vetëm nga LSDM-ja, por edhe nga partitë që i përfaqësojnë shqiptarët etnikë, si dhe grupet e tjera etnike. Në diskursin e tij të fushatës, z. Pendarovski e potencoi përkushtimin e tij për një shoqëri multietnike dhe e mbështeti fuqimisht ligjin e ri për përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe. Z. Reka bëri fushatë në të dy gjuhët, atë shqipe dhe maqedonase, edhe pse kampanja e tij ishte e fokusuar në shqiptarët etnik. Disa parti që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike morën pjesë aktive në fushatë, veçanërisht në vendet ku janë të përqendruara bashkësitë e tyre. Bashkëbiseduesit nga komuniteti rom e informuan MVZ-në e ODIHR-it se edhe pse mbetet shumë për t'u bërë për t'u trajtuar nevojat e romëve, abuzimet, si për shembull presioni dhe blerja e votave ishin më pak të përhapura në këto zgjedhje.

Gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në jetën publike. Vetëm 4 nga 26 ministra qeveritarë janë gra, dhe 6 nga 81 kryetarë të komunave. Në fushatë, gratë, në përgjithësi, ishin më pak të dalluara. Edhe pse një kandidate ishte grua, gratë nuk u paraqitën aq shpesh si folëse të fushatës dhe pjesëmarrja e grave në ngjarjet e fushatës të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it ishte e ulët në mënyrë disproporcionale. Në diskursin e saj të fushatës, znj. Siljanovska Davkova shpesh i trajtoi çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, duke premtuar se si kryetare e shtetit ajo do të punojë për ta promovuar pjesëmarrjen e grave në kabinetin e saj dhe në jetën publike. Z. Pendarovski po ashtu u zotua se do ta avancojë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në politikë.

Gjatë fushatës u bënë përpjekje të kufizuara për t'i trajtuar shqetësimet e personave me aftësi të kufizuara, me ç'rast kandidatët kohë pas kohe bënë thirrje për masa të shtuara për ta përmirësuar integrimin e tyre në shoqëri.³⁹ Pozitivisht, në disa ngjarje të mëdha të fushatës u siguria interpretim në gjuhën e shenjave.

Financimi i fushatës

Financimi i fushatës është i rregulluar me Kodin Zgjedhor të vitit 2006, Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004 dhe Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave të vitit 2018. Shumica e rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës mbeten të patrajtuara, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me shqyrtimin e detajuar të raporteve të përkohshme, afatin e fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare dhe diapazonin e revizionit të tyre.⁴⁰

Partitë kanë të drejtë për mjete publike nëse kanë fituar së paku një për qind të votave në zgjedhjet paraprake parlamentare ose lokale. Kandidatët presidencialë nuk marrin drejtpërdrejtë mjete publike për fushatën, por pas ndryshimeve të vitit 2018 në Kodin Zgjedhor, reklamato politike në media do të kompensohen nga buxheti i shtetit. Kufiri i shpenzimeve të fushatës ishte 110 denarë për votues të regjistruar (gjithsej kap vlerën prej rreth 198 milionë denarësh ose 3.2 milionë euro).⁴¹ Disa bashkëbisedues e informuan MVZ-në e ODIHR-it për një marrëveshje joformale midis partive politike për t'i kufizuar edhe më shumë shpenzimet për reklamim në media, të iniciuar nga qeveria, për t'i ulur shpenzimet e përgjithshme nga buxheti i shtetit.

³⁸ Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2002, 64.2 për qind e popullsisë u deklaruan si maqedonas etnikë, 25.2 për qind si shqiptarë etnikë, 3.8 për qind si turq etnikë, 2.7 për qind si romë etnikë, 1.8 për qind si serbë etnikë, 0.8 për qind si boshnjakë etnikë, 0.5 për qind si vllah etnikë dhe 1 për qind si të tjerë. Në mungesë të të dhënave të fundit të regjistrimit, kontestohet përbërja aktuale etnike e vendit.

³⁹ Momentalisht nuk ka asnjë deputet me aftësi të kufizuara.

⁴⁰ Shih [Raportin e dytë për harmonizim nga rrethi i tretë i vlerësimit të GRECO-s të vitit 2014](#), dhe [Mendimi i përbashkët mbi Kodin Zgjedhor I ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut 2016](#), si dhe [Rekomandimi Rec\(2003\)4 I Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës](#).

⁴¹ 1 euro është përafërsisht 61 denarë.

Siç kërkohet me ligj, të tre garuesit në zgjedhje regjistruan numra unikë tatimorë dhe hapën llogari të veçanta bankare përmes të cilave u kryen të gjitha transaksionet financiare që kanë të bëjnë me fushatën. Donacionet janë të kufizuara në 3.000 euro për individët dhe 30.000 euro për personat juridikë, duke i përfshirë kontributet në natyrë.⁴² Pas ndryshimeve të vitit 2018 në Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe në Kodin Zgjedhor, partitë politike mund të marrin kredi bankare, të cilat mund të transferohen në llogaritë e fushatës së kandidatëve. Rregullativa për këto kredi dhe raportimi për to nuk e siguron transparencën e nevojshme.⁴³ Nuk ka rregulla të qarta për zhvillimin e fushatës nga palët e treta dhe nuk ka kërkesa për llogaridhënie për shpenzimet e bëra nga partitë politike që i mbështesin kandidatët.⁴⁴ Për më tepër, garuesit kishin kuptime të ndryshme për strukturën dhe kërkesat e raportimit, që rezultoi me stile të pa unifikuara të raportimit.⁴⁵

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është organi kryesor mbikëqyrës për financimin e politikave dhe të fushatave. Institucione të tjera po ashtu kanë kompetenca mbikëqyrëse dhe hetuese mbi financimin e fushatës.⁴⁶ Dy raporte të përkohshme u dorëzuan në KSHZ, ESHR dhe KSHPK nga secili garues para ditës së zgjedhjeve.⁴⁷ Nga ESHR-ja kërkohet që të bëjë revizion të raporteve përfundimtare që duhet të dorëzohen brenda katër muajve nga zgjedhjet, por diapazoni i revizionit të saj është i kufizuar në të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura nga garuesit.⁴⁸ Në përgjithësi, mangësitë rregullatore, si dhe kompetencat dhe burimet e kufizuara të institucioneve të përfshira, e zvogëluan transparencën e financimit të fushatës dhe efektivitetin e mbikëqyrjes.⁴⁹

Mediat

Ambienti mediatik është i larmishëm, dhe përbëhet nga rreth 250 media, duke përfshirë rreth 130 transmetues (tetë prej tyre, duke i përfshirë edhe tre kanalet publike, janë kanale televizive me mbulim tokësor kombëtar) dhe rreth 100 portale onlajn. Televizioni mbetet burimi më i rëndësishëm i informimit politik, ndërsa roli i mediave onlajn dhe i rrjeteve sociale si platforma për diskutim publik është në rritje. Bashkëbiseduesit e MNVZ-së i theksuan përmirësimet në lirinë e mediave në vitet e

⁴² Vlera e paraqitur e të hyrave që i pranuan garuesit ishte rreth 45 milionë denarë, nga të cilat rreth 31 milionë për z. Pendarovski, rreth 12 milionë denarë për znj. Siljanovska Davkova, dhe rreth 1 milionë denarë për z. Reka. Znj. Siljanovska Davkova e financoi fushatën e saj kryesisht me donacione nga individët, z. Reka me donacione nga personat juridikë, duke i përfshirë edhe partitë BESA dhe ASH, ndërsa z. Pendarovski me donacione nga LSDM-ja.

⁴³ Legjislacioni nuk e përcaktoi shumën maksimale të kredive dhe kushtet e kthimit të saj, duke përfshirë edhe kamatën. Paragrafi 171 i [Udhëzimit për Rregullativën për Partitë Politike të ODHR-it dhe i Komisionit të Venedikut të vitit 2011](#) (Udhëzimi për Rregullativën për Partitë Politike) rekomandon se "legjislacioni mund t'u lejojë partive dhe kandidatëve që të marrin edhe kredi për ta financuar (një pjesë të) fushatën ose aktivitetet e tyre. Është e rëndësishme që rregullat mbi transparencën të trajtohen në mënyrë të vazhdueshme me burime të këtilla".

⁴⁴ Llogaritë e partive u nënshtrohen revizioneve vjetore të cilat nuk bëjnë dallim në shpenzimet e fushatës në zgjedhjet presidenciale.

⁴⁵ Ministria e Financave lëshoi një shabllon për raportim që kërkon ndarje të detajuar të shpenzimeve, por vetëm z. Pendarovski e përdori atë. Z. Pendarovski i deklaroi rreth 30 milionë denarë dhe i kishte përfshirë edhe mjetet për reklamat e paguara, ndërsa znj. Siljanovska Davkova dhe z. Reka nuk i kishin përfshirë reklamat e paguara dhe kishin deklaruar rreth 2.2 milionë denarë dhe 1.5 milionë denarë, respektivisht.

⁴⁶ Sipas ligjit, edhe ESHR-ja edhe KSHPK-ja mund të iniciojnë raste në lidhje me shkeljet. Edhe pse Kodi Zgjedhor (neni 74-a) i urdhëron ESHR-së t'i shqyrtojë kundërshtimet në lidhje me shkeljet, ESHR-ja theksoi se nuk ka kompetenca hetuese për t'i shqyrtuar kundërshtimet e tilla.

⁴⁷ Raporti i parë u publikua në ueb faqet e agjencive respektive në kohë të duhur, por publikimi i raporteve të dyta mbetet pezull.

⁴⁸ Paragrafi 200 i [Udhëzimit për Rregullativën për Partitë Politike](#) rekomandon që raportet për financimin e fushatës të dorëzohen "brenda një periudhe jo më të gjatë se 30 ditë pas zgjedhjeve".

⁴⁹ Neni 7.3 i [Konventës së KB-ve Kundër Korrupsionit të viti 2003](#) kërkon nga vendet që "të konsiderojnë marrjen e masave të përshtatshme legjislative dhe administrative... për ta rritur transparencën në financimin e kandidaturave për funksionet e zgjedhura publike dhe, kur është e mundur, financimin e partive politike". Paragrafi 214 i Udhëzimeve për Rregullativën për Partitë Politike rekomandon se "autoritetit rregullator duhet t'i jepet kompetenca për t'i monitoruar llogaritë dhe për të bërë revizione të raporteve financiare. Procesi [...] duhet të përcaktohet në legjislacionin përkatës". Shih po ashtu paragrafin 220.

fundit.⁵⁰ Në të njëjtën kohë, ata vunë në dukje ambientin e mbingarkuar të mediave brenda një tregu të kufizuar për reklamim, rrogat e ulëta dhe rënien e interesit për profesionin e gazetarisë, gjë që në përgjithësi paraqet një shqetësim për cilësinë e raportimit dhe qëndrueshmërinë financiare të mediave.

Pas heqjes së taksës për radiodifuzion në vitin 2017, transmetuesi publik financohet ekskluzivisht nga buxheti i shtetit. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se kjo strukturë e financimit mund ta dëmtojë pavarësinë e transmetuesit publik. Në viti 2018 qeveria futi subvencione për gazetat me qëllim që ta mbështesë këtë segment tradicional, ndërsa ligji u ndryshua për ta ndaluar reklamimin e fushatave publike përmes mediave transmetuese, praktikë kjo që u perceptua si mekanizëm për blerjen e mbulimit të favorshëm me mjete publike. Një numër i mediave të shquara private mbeten të financuara nga biznese të afërta me grupet politike.

Korniza ligjore parasheh rregullim të hollësishëm të sjelljes së mediave gjatë fushatës zgjedhore. Megjithatë, dispozita të ndryshme i referohen vetëm mbulimit të partive politike e jo edhe të kandidatëve presidencialë. Këto dispozita u zbatuan nga KSHZ-ja, në përputhje me marrëveshjen e ndërmjetësuar nga qeveria dhe partitë politike parlamentare, sipas të cilës Z. Pendarovski dhe Znj. Siljanovska Davkova do të përdornin pjesë të barabarta të reklamave të paguara në media, ndërsa Z. Reka rreth një të tretën e pjesës së tyre.⁵¹ Transmetuesi publik është i obliguar të emetojë promovim politik falas, ndërsa llojet e tjera të mediave, duke i përfshirë edhe portalet në internet, kanë të drejtë të ofrojnë reklama të paguara politike.⁵² Shumë bashkëbisedues të MNVZ-së e kritikuan mungesën e konsultimeve publike për përdorimin e mjeteve publike për t'i kompensuar reklamimet politike. Disa të tjerë e mbështetën përpjekjen për t'u garantuar qasje në reklamimin në media të gjithë garuesve.⁵³

Kodi Zgjedhor parasheh se transmetuesit që i mbulojnë zgjedhjet janë të obliguar që këtë ta bëjnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme në të gjitha përmbajtjet e tyre programore. Që nga 9 shkurti, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM) e monitoroi respektimin e kërkesave për mbulimin e fushatës nga ana e mediave dhe publikoi tre raporte gjithëpërfshirëse nga monitorimi. Në përputhje me ligjin, ajo i ofroi informata KSHZ-së për çdo ditë.⁵⁴ ASHAAM-i identifikoi dy shkelje të kërkesave ligjore dhe gjithashtu ua kujtoi transmetuesve ndalesën për t'i shfaqur fëmijët në materialet promovuese të garuesve.

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it konstatoi se transmetuesi publik mundësoi mbulim të pavarur, dhe gjithashtu mediat prezantuan informata të ndryshme për kandidatët dhe partitë politike që i mbështesin ata, në kuadër të programeve të ndryshme dhe pesë debateve televizive me të gjithë kandidatët.⁵⁵ Kjo u ofroi mundësi votuesve që të marrin vendim në bazë të informatave. Përveç debatit,

⁵⁰ Megjithatë, më 17 Prill, një ekip i mediave të TV21 u frikësuan dhe kërcënuan verbalisht në Haraçinë. Shih gjithashtu [deklaratën e Përfaqësuesit për Liri të Mediave të OSBE-së](#).

⁵¹ Kodi Zgjedhor (neni 75-f (1)) e definon ndarjen e reklamimit të paguar politik vetëm ndërmjet partive politike, në bazë të statusit të tyre (në pushtet, opozitare, parti joparlamentare).

⁵² Të gjitha mediat e interesuara private duhej t'i shpallnin listat e tyre të çmimeve për reklamimet paguara politike brenda 5 ditëve nga shpallja e zgjedhjeve, ndërsa portalet në internet, përveç kësaj duhej të regjistroheshin edhe në KSHZ brenda 3 ditëve nga shpallja e zgjedhjeve. Sipas ueb-faqes së KSHZ-së, 92 transmetues, 83 media onlajn dhe 6 gazeta e respektuan këtë afat. KSHZ-ja nuk i morri parasysh mediat të cilët humbën afatet për paraqitje të çmimeve. Megjithatë, një Gjykatë Themelore i kërkoi KSHZ-së të rivendos një media të tillë, *ITV*, në listën e ueb-faqeve dhe kanali filloi me transmetim të reklamave të paguara politike.

⁵³ Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, mungesa e rregullativës për portalet në internet, të cilat zyrtarisht nuk e kanë statusin e mediave bëri që disa portale të synojnë të marrin mjete publike pa asnjë aktivitet të mëparshëm ose me histori të shpërndarjes së dezinformatave, që e vuri në pikëpyetje besueshmërinë e tyre. Një portal i regjistruar në listë ishte vendosur si llogari në "Facebook", ndërsa disa të tjera ishin regjistruar në gjuhë të ndryshme.

⁵⁴ ASHAAM-i publikoi dy raporte para fushatës zgjedhore dhe një pas saj. Ajo bëri monitorim 24 orë në javë, duke përfshirë edhe tonin e mbulimit, të 15 kanaleve televizive para fushatës dhe të 32 kanaleve gjatë fushatës.

⁵⁵ Monitorimi u bë çdo ditë nga ora 18:00 deri në orën 24:00 në kanalet *RTM1* dhe *RTM2* (në gjuhën maqedonase dhe shqipe, respektivisht) dhe kanalën privat *Alfa* (në gjuhën maqedonase), *Alsat-M* (dygjuhësh), *Kanal 5*, *Sitel*, *Telma*,

transmetuesi publik emetoi intervista me dy kandidatë, por vendosi të mos emetojë asnjë prezantim tjetër politik falas.⁵⁶

Shumica e kanaleve të monitoruara mbuluan të tre garuesit në menyrë të krahasueshme, me informata të forta neutrale.⁵⁷ Televizioni publik RTVM1 i dedikoi z. Pendarovskit rreth 17 përqind, znj. Siljanovska Davkova 15 dhe z. Reka 13. Udhëheqësit e LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së gjithashtu u paraqitën rregullisht.⁵⁸ Përveç kësaj, të gjitha kanalet e monitoruara dedikuan pjesë të rëndësishme të mbulimit politik të aktiviteteve të qeverisë (21-37 përqind), duke përfshirë të dyja raportimin pozitiv dhe negativ.

Mediat onlajn dhe ato të shkruara ofruan nivele të ndryshme të mbulimit të fushatës presidenciale, herë pas here me mangësi balansi në tonalitet dhe mbulim. Për shembull, gazeta *Sloboden Pecat* paraqiti më tepër mbulim negativ apo neutral të znj. Siljanovska Davkova, përderisa mbulimi i të dy z. Pendarovski dhe z. Reka ishte kryesisht neutral apo pozitiv. Portali i lajmeve online kurir.mk tregoi mbulim të favorshëm të znj. Siljanovska Davkova, ndërsa mbulimi i z. Pendarovski ishte kryesisht negativ dhe i z. Reka neutral.⁵⁹ Në shumicën e mediave të monitoruara, garuesit u paraqitën në mënyrë më të krahasueshme, si në aspekt të hapësirës ashtu edhe në aspekt të tonit.

Kundërshtimet dhe ankesat

KSHZ-ja e trajton shumicën e kundërshtimeve në lidhje me zgjedhjet, ndërsa ESHR-ja dhe KSHPK-ja i trajtojnë kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore, respektivisht.⁶⁰ Përderisa për vendimet e KSHZ-së në lidhje me kundërshtimet dhe anulimin e rezultateve mund të parashtrihen ankesa në Gjykatën Administrative, vendimet dhe veprimet e tjera nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.⁶¹ Ngjashëm, nuk ka shqyrtim gjyqësor në kohë të rregullave të KSHZ-së.⁶² Vetëm garuesit mund t'i kontestojnë parregullsitë e votimit dhe rezultatet e zgjedhjeve. Votuesit mund ta kontestojnë vetëm shkeljen e të drejtës së tyre për të votuar, ndërsa vëzhguesit qytetarë nuk kanë të drejtë të parashtrijnë kundërshtime në lidhje me vëzhgimin e tyre.⁶³ Përgjigjet me shkrim të KSHZ-së për refuzimin e kundërshtimeve të papranueshme nuk konsiderohen si vendime dhe për to nuk mund të parashtrihet ankesë. Në përgjithësi, korniza ligjore nuk ofron kompensim ligjor

24 *Vesti* (në gjuhën maqedonase). U monitoruan edhe artikujt që kanë të bëjnë me politikën të gazetave *Koha* (në gjuhën shqipe), *Nezavisen Vesnik* dhe *Nova Makedonia* (në gjuhën maqedonase), si dhe të mediave onlajn www.kurir.mk, www.sdk.mk, www.plusinfo.mk (në gjuhën maqedonase), www.lajmpress.mk (në gjuhën shqipe) gjithashtu u monitoruan.

⁵⁶ Sipas transmetuesit publik, nuk kishte kërkesa të tilla nga garuesit. Z. Siljanovska Davkova nuk morri pjesë në intervistë me këtë transmetues.

⁵⁷ *Sitel TV* u fokusua më tepër në z. Pendarovski (20 përqind) dhe znj. Siljanovska Davkova (18 përqind), përderisa z. Reka kishte diku rreth 6 përqind

⁵⁸ VMRO-DPMNE kishte rreth 9 (*Alsat-M*) deri më 19 përqind (*Sitel*) të mbulimit politik, dhe LSDM-ja rreth 1 (*Alsat-M dhe RTVM 2*) deri 6 përqind (*Sitel*). Udhëheqësit të LSDM-së ju dha në mes 6 (*Sitel*) dhe 10 përqind (*Alfa dhe Alsat-M*), në kapacitetin e tij si Kryeministër.

⁵⁹ Z. Pendarovski kishte 24 përqind të mbulimit politik, znj. Siljanovska Davkova 23 dhe z. Reka 6.

⁶⁰ Ligji parashih që KZK- të vendosin se për kundërshtimet, por nuk e specifikon se cilat kundërshtime janë nën kompetencën e tyre. Në praktikë, KZK-të nuk i shqyrtuan kundërshtimet.

⁶¹ Shih Paragrafin 5.10 të [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) dhe paragrafin 18.2 të [Dokumentit të Moskës të OSBE-së të vitit 1991](#), dhe [Rekomandimin \(2004\)-20](#) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative. [Kodi i praktikës së mirë](#) rekomandon që "Organi i ankimit për çështje zgjedhore duhet të jetë ose komisioni zgjedhor ose gjykata. Në çdo rast, duhet të jetë i mundur ankimi përfundimtar në gjykatë".

⁶² Ligjshmëria e rregullave mund të kontestohet në Gjykatën Kushtetuese, megjithatë, ajo nuk ka afate të shpejta për shqyrtimin e rasteve të tilla.

⁶³ Kundërshtimet e parashtruara nga dy kandidatë të pasuksesshëm në lidhje me procesin e mbledhjes së nënshkrimeve dhe një kundërshtim nga vëzhguesit qytetarë në lidhje me zhvillimin e pretenduar të hershëm të fushatës nuk u pranuan sepse sipas ligjit kundërshtuesit nuk kishin të drejtë të parashtrijnë kundërshtime të tilla.

efektiv dhe të plotë që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.⁶⁴

Një numër shumë i vogël i kundërshtimeve u parashtruan në KSHZ në periudhën parazgjedhore.⁶⁵ KSHZ-ja i shqyrtoi kundërshtimet brenda afatit ligjor, por vendimet nuk kishin arsyetim të pavarur. Sistemi elektronik për ndjekjen e kundërshtimeve nga ana e KSHZ-së, që kërkohet nga Kodi Zgjedhor, nuk ishte funksional në periudhën parazgjedhore, gjë që e zvogëloi transparencën e zgjidhjes së kundërshtimeve.

KSHPK-ja pranoi 13 kundërshtime në lidhje me zgjedhjet nga VMRO-DPMNE-ja ku pretendohet se janë filluar në mënyrë të paligjshme projekte të infrastrukturës, se janë bërë punësime të paligjshme dhe shpenzimeve të tjera të paligjshme gjatë periudhës së zgjedhjeve. Shumica e kundërshtimeve, u hodhën poshtë si të pabaza.⁶⁶ Të gjitha rastet u shqyrtuan brenda afateve ligjore, në mbledhje publike, dhe vendimet u publikuan brenda 24 orëve edhe pse nuk ka afat për përfundim të rasteve. Përveç kësaj, Prokurori publik pranoi një kundërshtim në lidhje me blerje të pretenduar të votave, për të cilin ende nuk është marrë vendim.

Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgimin e gjithë procesit zgjedhor nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë, si dhe nga përfaqësuesit e garuesve në zgjedhje. Për t'u akredituar, shoqatat e vendit dhe organizatat e huaja duhet të jenë regjistruar së paku një vit përpara ditës së zgjedhjeve dhe statutet e tyre të themelimit duhet ta përfshijnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Vëzhguesit qytetarë dhe ata ndërkombëtarë u akredituan në mënyrë inkluzive. Duke pasur parasysh interesin e shtuar për t'i vëzhguar zgjedhjet, KSHZ-ja e zgjati periudhën për dorëzimin e aplikimeve për akreditim. KSHZ-ja akreditoi mbi 3.000 vëzhgues qytetarë dhe rreth 400 vëzhgues ndërkombëtarë. Asociacioni qytetar "MOST" shpërndau diku 200 vëzhgues, ndërsa Qendra për Liri - CIVIL shpërndau rreth 160 vëzhgues në ditën e zgjedhjeve. Disa shoqata të personave me aftësi të kufizuara, si për shembull "Inkluziva", po ashtu i vëzhguan zgjedhjet.

Dita e zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe pjesëmarrja e votuesve nga njoftimi paraprak nga ana e KSHZ-së ishte 41.8 përqind, megjithatë me ndryshime në regjione. KSHZ-ja filloi shpalljen e rezultateve paraprake në ueb-faqen e sajë më pak se një orë pas mbylljes së vendvotimeve, të ndara sipas komunave dhe vendvotimeve, duke mundësuar një shkallë të lartë të transparencës.

Hapja e vendvotimeve u vlerësua pozitivisht në 78 nga 79 vendvotimet e vëzhguara. Anëtarët e KZ-ve në përgjithësi ishin të vetëdijshëm për procedurat dhe punuan në mënyrë transparente, edhe pse kishte 19 raste në të cilat protokollet nuk ishin të plotësuar dhe ishin të nënshkruara para fillimit të votimit,

⁶⁴ Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) thotë se "çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor". Seksioni II.3.3.3.f i [Kodit të praktikës së mirë](#) rekomandon se "të gjithë kandidatët dhe të gjithë votuesit e regjistruar në zonën përkatëse zgjedhore duhet ta kenë të drejtën e ankimit". Shih po ashtu nenin 2.3 (a) të [Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1976](#).

⁶⁵ KSHZ-ja pranoi dhe e refuzoi një kundërshtim në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe tre kundërshtime në lidhje me zhvillimin e hershëm të fushatës. Gjykata Administrative e vërtetoi vendimin e KSHZ-së për të mos e përfshirë një votues në listën e votuesve për shkak të mungesës së dokumenteve të vlefshme dhe vendbanimit zyrtar.

⁶⁶ Nëntë u huldën poshtë, dy u përkrahën pjesërisht dhe një plotësisht. Një kundërshtim u dërgua në Prokurorinë Publike për hetimin e një veprë të mundshme penale. Për më tepër, KSHPK-ja inicoi dy raste *ex officio*.

dhe 12 raste në të cilat u vërejt se kutia e votimit nuk ishte e zbratur. Tetëmbëdhjetë nga vendvotimet e vëzhguara u hapën me vonesë të shkurtër. Sipas KSHZ-së një vendvotim nuk u hap aspak.

Gjatë ditës, vëzhguesit e vlerësuan procesin e përgjithshëm si transparent, gjë që ishte e përkrahur me prezencë të vëzhguesve civil (39 përqind nga vëzhgimi) dhe përfaqësues të kandidatëve (70 përqind).

Mbajtja e votimeve u vlerësua pozitivisht nga ana e MNVZ-së në 99 përqind të vëzhgimeve. Procesi i votimit ishte i qetë dhe procedurat u ndoqën në gati se të gjitha vendet e vëzhguara, duke përfshirë kontrollimin e identifikimit të votuesit, sigurimin që votuesit janë nënshkruar në listën e votuesve si dhe ngjyrosjen e gishtit të votuesve. Vëzhguesit vërejtën që anëtarët e KZ-ve jo gjithmonë i udhëzuan votuesit si të shënojnë siç duhet fletëvotimet. Numri i lartë i fletëvotimeve jovalide (4.3 përqind, sipas KSHZ-së, duke përfshirë dhe votat boshe) theksoi nevojën për instruksione dhe trajnime më të qarta.

MNVZ-ja vëzhgoi një numër të konsiderueshëm të votuesve të cilët u larguan, duke përfshirë këtu edhe votues të cilëve kohëve të fundit ju ishin lëshuar dokumentet e identifikimit. Disa votues gjithashtu nuk u gjetën në lista gjatë votimit të hershëm të vëzhguar nga ana e MVZ-së së ODIHR-it në institucionet ndëshkimore më 20 Prill. Përderisa në shume raste votuesit u ridrejtuan në vendvotime tjera, këto vëzhgime përforcojnë shqetësimet lidhur me përfshirjen e të gjithë votuesve në regjistrin e votuesve.

Në përgjithësi, nuk u vëzhguan shkelje madhore gjatë ditës së zgjedhjeve. Megjithatë, vëzhguesit e MNVZ-së vunë në dukje 25 raste të votimit në grupe, që kryesisht ndikon pjesëmarrjen e grave.

Përderisa qasja e pavarur e personave me aftësi të kufizuara në godinat e vendvotimeve u vëzhgua në vetëm 46 përqind të vëzhgimeve, në 80 përqind të vëzhgimeve planifikimi i vendvotimeve ishte i përshtatshëm për votuesit me aftësi të kufizuara, dhe gati se të gjitha vendvotimet e vëzhguara ishin të pajisura me kornizën e fletëvotimit të shkrimit Brail. Në disa raste vëzhguesit e MNVZ-së vunë në dukje se procedurat për ndihmën e votuesve me aftësi të kufizuara nuk u respektuan.

Numërimi u vlerësua në përgjithësi si pozitiv. Nuk u ngritën shqetësime lidhur me saktësinë e numërimit të votave dhe vlefshmëria e fletëvotimeve u përcaktua në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, MNVZ-ja vëzhgoi se KZ-të shpesh harruan procedurat e rëndësishme të masave mbrojtëse, siç është tregimi i numrit të fletëvotimeve të përdorura (19 vëzhgime) dhe përcaktimin e numrit të votuesve që kanë nënshkruar listën e votuesve (17 vëzhgime) para hapjes së kutisë së votimit.

Procedurat ishin të ndjekura në përgjithësi gjatë nxjerrjes në tabelë të të dhënave në KZK-të dhe procesi u vlerësua si pozitiv në të gjitha, përveç në njërin nga vëzhgimet. Vëzhguesit vunë në dukje praktikën e ndryshme të KZK-ve lidhur me zgjidhjen e mospërputhjeve në të dhënat e protokolleve të KZ-ve, që sugjeroi mungesë të udhëzimeve adekuata nga ana e KSHZ-së lidhur me këtë çështje.

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 22 prill 2019 – Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) të OSBE-së, Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP të OSBE-së) dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE). Vlerësimi u bë që të caktohet se a u mbajtën zgjedhjet në përputhje me përkushtimet e OSBE-së, Këshillit të Evropës dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin shtetëror.

Znj. Sereine Mauborgne u zgjodh nga kryesuesi i OSBE-së si koordinatore e posaçme dhe udhëheqëse e misionit vëzhgues afatshkurtër të OSBE-së. Z. Reinhold Lopatka e udhëhoqi delegacionin e AP të OSBE-së. Znj. Marie-Christine Dalloz e udhëhoqi delegacionin APKE-së. Znj. Corrien Jonker është shefi i MVZ-së së ODIHR-it, që filloi me punë më 11 mars.

Secila nga institucionet e përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve e kanë miratuar Deklaratën e parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005. Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet paraprake është dorëzuar para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit, duke përfshirë numërimin, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e kundërshtimeve dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. ODIHR-i do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, duke përfshirë rekomandime për përmirësime eventuale, diku rreth dy muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor. AP e OSBE-së do t'a paraqesë raportin e saj në Korrik në Luksemburg APKE-ja do t'a paraqesë raportin e saj në mbledhjen e Komitetit të Përhershëm më 24 Maj në Paris.

MVZ-ja e ODIHR-it përfshin 11 ekspertë në kryeqytet dhe 18 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë anembanë vendit. Në ditën e zgjedhjeve u shpërndanë 240 vëzhgues nga 38 vende, duke përfshirë 189 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të shpërndarë nga ODIHR-i, si dhe një delegacion 40 -anëtarësh nga AP-ja e OSBE-së dhe një delegacion 12-anëtarësh nga APKE-ja. Hapja u vëzhgua në 87 vendvotime, ndërsa votimi u vëzhgua në 979 vendvotime anembanë vendit. Numërimi i votave u vëzhgua në 87 vendvotime, ndërsa nxjerrja e rezultateve në 69 KZK. Votimi i hershëm u vëzhgua në 13 vendvotime speciale një ditë para ditës së zgjedhjeve.

MNVZ-ja dëshiron t'i falënderojë autoritetet për ftesën për t'i vëzhguar zgjedhjet dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për ndihmën e tij. MNVZ-ja poashtu dëshiron ta shprehë falënderimin e saj ndaj institucioneve të tjera, partive politike, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për informata plotësuese ju lutemi kontaktoni:

- Corien Jonker, Shefe i MVZ-së së ODIHR-it në Shkup (+389 72 443 752);
- Katya Andrusz, Zëdhënëse e ODIHR-it (+ 389 72 807 826 ose +48 725 880 257), ose Keara Castaldo, Këshilltare për zgjedhjet e ODIHR-it, në Varshavë (+48 603 638 999);
- Andreas Baker, AP e OSBE-së, (+ 389 70 636 321 ose +45 601 08126);
- Chemavon Chahbazian, APKE, (+ 389 70 636 302 ose +33 650 68 76 55).

Adresa e MVZ-së së ODIHR-it:

Nikola Klusev 6, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut

Tel: +389 2 3222558; Fax: +389 2 3226776; E-mail: office@odih.mk

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*